



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

**DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE
DHE INDUSTRIË**

Nr. 2637/prot.
1

Tiranë, më 04.03.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.695/1, datë 18.09.2015.

**SHOQËRISË “GPA KONSTRUKSION” SH.P.K
Rruga “Jordan Misja” Nr. 1/1, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lorid Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “GPA Konstruktion” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.695/1, datë 18.09.2015, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krastë”, Krujë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.1668/1 datë 28.02.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.2603 date 28.02.2019 dhe me shkresën nr. 1825, datë 01.03.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.2637 datë 01.03.2019, është propozuar revokimi i lejes minerare të nr.695/1, datë 18.09.2015, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krastë”, Krujë, për arsye se:

- Nuk ka realizuar shfrytëzimin në përputhje me projektin e miratuar, pasi nuk ka respektuar radhën e shfrytëzimit nga lart poshtë.
- Nuk ka realizuar prodhimi e programuar duke raportuar për vitin 2018 në sasi minerali prej $540m^3$, nga $50000m^3$ /vit që duhet të kishte bërë sipas programit.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germen “dh”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.695/1, datë 18.09.2015, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krastë”, Krujë, që shoqëria juaj zotëron.**

Duhet të paguani si difference rehabilitimi shumën 423917 lekë, pasi nga 916610 lekë që duhet të kishit paguar sipas sipërfaqes se prekur nga shfrytëzimi, keni paguar 492693 lekë.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.695/1, datë 18.09.2015, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krastë”, Krujë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

